

VENDIM
Nr. 153, datë 10.3.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 8, DATË 6.1.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE TË KRITEREVE TË
PËRFITIMIT TË SIPËRFAQEVE NDËRTIMORE NË OBJEKTET E REJA PËR
BANIM NGA SUBJEKTET QË POSEDOJNË NDËRTIME TË KLASIFIKUARA SI
NDËRTIME PA LEJE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 33, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 8, e vendimit nr. 8, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. Sipërfaqja ndërtimore në objektet e reja për banim, që përfitojnë poseduesit e ndërtimeve pa leje, është 100 për qind e sipërfaqes së objektit pa leje.”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, njësitë e vetëqeverisjes vendore, njësitë zbatuese, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama